



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS

NJOFTIM PËR SHTYP

**Rasti: Përftimi i kontrollit të GORENJE GOSPODINJSKI APARATI D.D. nga
HISENSE GROUP CO., LTD.**

Përfaqësuesi ligjor i Hisense Group Co. Ltd, Wolf Theiss SHPK, ka informuar Autoritetin e Konkurrencës me shkresën Nr. 408 Prot., të Autoritetit të Konkurrencës të datës 27.06.2018“ Konfirmim i Depozitimit të Dokumenteve”, lidhur me një transaksion që synon përfitim të kontrollit të Gorenje Gospodinjski Aparati D.D. nga Hisense Group Co., Ltd.

Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse:

Blerësi: Hisense Group Co., Ltd, Kati 24, Building Hisense, Rruga Donghai Ëest nr.17, qarku Shinan, Qyteti Qing Dao, Republika Popullore e Kinës (këtu e më poshtë Hisense). Hisense është themeluar në Republikën Popullore të Kinës dhe zotërohet 100% nga Komisioni i Mbikëqyrjes dhe Administrimit të Pasurive Shtetërore të Bashkisë së Qingdao, Kinë. Hisense është prodhuesi dhe furnizuesi kryesor i pajisjeve elektronike dhe teknologjisë së informacionit në Kinë me katër segmente kryesore biznesi: pajisjet shtëpiake, multimedia, sistemet inteligjente informatike IT dhe zhvillimin e pronës. Hisense është kryesisht aktiv në Kinë dhe në rajonin e Azisë/Paqësorit.

Shqipëri; Hisense ushtron aktualisht aktivitetet biznesi që ka të bëjë me furnizimin e disa kategorive të pajisjeve të mëdha shtëpiake, të quajtura Mallra të Bardha, si p.sh. frigoriferë, ngrirës, lavatriceve. Hisense shet Mallra të bardha tek një shitës i madh me pakicë Merja Outlet SHPK.

Shitësi: Gorenje Gospodinjski Aparati d.d. një shoqëri aksionare e organizuar sipas ligjeve të Sllovenisë, e regjistruar në gjykatën e Sllovenisë dhe regjistrin tregtar me numër regjistrimi 51636760000 me seli në Velenjë, Slloveni dhe me adresë: Partizanska Cesta 12, 3320 Velenjë, Slloveni (këtu e më poshtë Gorenje). Gorenjë është shoqëria mëmë e Gorenje Group që është aktive në prodhimin, shitjen dhe servisin e pajisjeve elektrike dhe jo-elektrike shtëpiake dhe elektro-termike; frigoriferë, grirësit dhe sistemet e ftohjen, lavatrice, tharëse dhe lavastovilje, sobat elektrike dhe gaz, furrat dhe sobat e kombinuara, etj. Gorenje është aktive në më shumë se 90 vende në të gjithë botën. Shoqëria është prodhues dhe furnizues i një game të plotë mallrash të bardha në veçanti i pajisjeve të gatimit (pllakat, pianurat, sobat e gatimit dhe furrat), aspiratorët, larëse enësh, frigoriferët, grirësit, furrat me mikrovalë, lavatricet etj.

Shqipëri: Gorenjë është prezentë përmes degës së saj Gorenje Albania SHPK. Pjesa më e madhe e shitjeve arrihet përmes furnizimit të Mallrave të bardha.

Përqendrimi i propozuar ka të bëjë me përfitimin e kontrollit të vetëm të Gorenjës nga Hisense, nëpërmjet një tenderi me ofertë publike. Blerësi direkt i aksioneve të Gorenjës do të jetë Hisense Luxembourg Home Appliance Holdings Sarl, Luxemburg, i cili kontrollohet drejtpërdrejtë nga Hisense.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Si pasojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.